



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE MBI ROLIN E TEKNOLOGJISË ASISTIVE NË PËRMIRËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE ME VËSHTIRËSI NË TË NXËNË

Autori:

Qëndresa Hasani

Mentori:

Prof. Dr. Naser Zabeli

Programi:

Edukim Inkluziv

Viti akademik:

2025/2026

Studimi është motivuar nga të kuptuarit se integrimi efektiv i teknologjisë asistive në procesin mësimor mund të përmirësojë rezultatet akademike të nxënësve me vështirësi në të nxënë. Në një kontekst arsimor gjithnjë e më të larmishëm, ku diversiteti i nevojave edukative është evident, është thelbësore të kuptohet se cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve ndaj teknologjisë asistive marrë parasysh ndikimin e drejtëpërdrejtë në formën dhe mënyrën e implementimit të kësaj teknologjie. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte të identifikojë qëndrimet e mësimdhënësve në Kosovë lidhur me rolin e teknologjisë asistive në përmirësimin e arritjeve akademike të nxënësve me vështirësi në të nxënë.

Pyetjet hulumtuese

Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve mbi rolin e teknologjisë asistive në përmirësimin e arritjeve të nxënësve me vështirësi në të nxënë?

Si ndikon përdorimi i teknologjisë asistive në angazhimin dhe arritjet akademike të nxënësve me vështirësi në të nxënë?

Çfarë barrierash hasin mësimdhënësit në implementimin e teknologjisë asistive?

Hipotezat

H1- Mësimdhënësit kanë qëndrime pozitive ndaj efektivitetit të teknologjisë asistive në përmirësimin e arritjeve të nxënësve me vështirësi në të nxënë.

H2- Përdorimi i teknologjisë asistive ndihmon në përmirësimin e rezultateve akademike të nxënësve me vështirësi në të nxënë.

H3- Barrierat në implementimin e teknologjisë asistive ndërlidhen me mungesën e trajnimeve.

Hulumtimi është realizuar duke përdorur një qasje sasiore të mbledhjes së të dhënave përmes një pyetësoi të strukturuar, i administruar tek 100 mësimdhënësit nga nivele të ndryshme arsimore dhe nga qytete të ndryshme të Kosovës. Analiza e të dhënave është kryer përmes programit statistikor SPSS, me fokus në përshkrimin e mostrës, vlerësimin e besueshmërisë së instrumentit, përpunimin e statistikave përshkruese sipas seksioneve të pyetësoi, testimin e hipotezave si dhe analizat shitesë statistikore.

Të dhënat tregojnë se mësimdhënësit kanë qëndrime dukshëm pozitive ndaj ndikimit të teknologjisë asistive dhe e vlerësojnë atë si një mjet që mund të lehtësojë të nxënë dhe rrisë përfshirjen e nxënësve me vështirësi në të nxënë. Megjithatë, theksohet se zbatimi i teknologjisë asistive përballet me një sërë pengesash praktike si; mungesa e pajisjeve adekuate, mbingarkesa e orarit të mësimdhënësve dhe mungesa e mbështetjes së duhur institucionale. Trajnimi profesional del si një element i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në kompetencën dhe vetëefikasitetin e mësimdhënësve për zbatimin e teknologjisë asistive. Në përfundim, studimi thekson nevojën për investime më të mëdha në pajisje dhe mjete asistive, zhvillimin e programeve të qëndrueshme të trajnimit profesional dhe krijimin e kushteve më të favorshme organizative në shkolla. Rezultatet e këtij hulumtimi mund të shërbejnë si udhërrëfyes për politikëbërësit dhe punonjësit e arsimit në planifikimin dhe zbatimin e strategjive për integrimin e teknologjisë asistive.

Fjalët kyçe: teknologji ndihmëse, vështirësi në të nxënë, qëndrime të mësimdhënësve.

Extended Abstract

Title of the Paper:

TEACHERS ATTITUDES ON THE ROLE OF ASSISTIVE TECHNOLOGY IN IMPROVING THE ACHIEVEMENTS OF STUDENTS WITH LEARNING DIFFICULTIES

Author:

Qëndresa Hasani

Mentor:

Prof. Dr. Naser Zabeli

Program:

Inclusive Education

Academic Year:

2025/2026

The study is motivated by the understanding that the effective integration of assistive technology into the teaching process can improve the academic results of students with learning difficulties. In an increasingly diverse educational context, where the diversity of educational needs is evident, it is essential to understand what teachers' attitudes towards assistive technology are, considering the direct impact on the form and manner of implementation of this technology. The main purpose of this research was to identify the attitudes of teachers in Kosovo regarding the role of assistive technology in improving the academic achievements of students with learning difficulties.

Research questions

What are the attitudes of teachers on the role of assistive technology in improving the achievements of students with learning difficulties?

How does the use of assistive technology affect the engagement and academic achievements of students with learning difficulties?

What barriers do teachers encounter in implementing assistive technology?

Hypotheses

H1-Teachers have positive attitudes towards the effectiveness of assistive technology in improving the achievements of students with learning difficulties.

H2-The use of assistive technology helps in improving the academic results of students with learning difficulties.

H3- Barriers to the implementation of assistive technology are related to the lack of training.

The research was conducted using a quantitative approach to data collection through a structured questionnaire, administered to 100 teachers from different educational levels and from different cities in Kosovo. Data analysis was performed using the SPSS statistical program, focusing on sample description, instrument reliability assessment, descriptive statistics processing according to questionnaire sections, hypothesis testing and additional statistical analyses. The data show that teachers have highly positive attitudes towards the impact of assistive technology faces a number of practical obstacles such as; lack of adequate equipment, overloaded teacher schedules and lack of appropriate institutional support. Professional training emerges as an important element that directly affects the competence and self-efficacy of teachers in the implementation of assistive technology. In conclusion, the study emphasizes the need for greater investment in assistive devices and tools, the development of sustainable professional training programs, and the creation of favorable organizational conditions in schools. The results of this research can serve as a guide for policymakers and education professionals in planning and implementing strategies for integrating assistive technology.

Keywords: assistive technology, learning disabilities, teacher attitudes.